




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA

KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



N.SH. Internet "Albi@Net"
Numri i biznesit - 80561776
Pronare – Dinore GASHI
OSH INTERNET ALBI@NET
Malishevë

Ref:1901/055/LIC/ni

VENDIM

për ndërprerjen e licencës të Operatorit të Shpërndarjes (OSH) INTERNET ALBI@NET, me seli në Kijevë, komuna e Malishevës

Faktet

1. Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM), në bazë të nenit 3, paragrafi 2.6. të ligjit për KPM (Ligji nr. 04/L-44), nxjerr akte nënligjore për rregullimin e transmetimit dhe të shërbimeve mediale audio-vizuele, të cilat nevojiten për të kryer funksionet e saj në pajtim me standardet ndërkombëtare.
2. INTERNET ALBI@NET është operator i shpërndarjes i licencuar nga Komisioni i Pavarur për Media (KPM), për shpërndarjen e shërbimeve mediale audio dhe audiovizuale përmes rrjetit kabllorë, në pajtim me Rregullorën KPM-2016/01, me seli në Prizren. KPM, me datën 6 qershor 2013, ka marr vendim për dhënien e licencës për operatorin e shpërndarjes INTERNET ALBI@NET.
3. Më datën 22 dhjetor 2018, pronarja e operatorit të shpërndarjes INTERNET ALBI@NET, përmes një shkrese të dorëzuar në KPM, ka njoftuar se heq dorë nga licenca e operatorit të shpërndarjes.

Arsyetimi

4. Duke marrë parasysh njoftimin e pronares të operatorit të shpërndarjes INTERNET ALBI@NET, për heqje dorë nga licenca në mënyrë vullnetare, Komisioni konstaton, se ka bazë të mjaftueshme për ndërprerjen e licencës së INTERNET ALBI@NET.

VENDIM

5. Komisioni, në takimin e tij të mbajtur më datën 31 janar 2019, merr vendim për ndërprerjen e licencës së operatorit të shpërndarjes INTERNET ALBI@NET, ndërsa,

1/2

shlyerja e obligimeve ndaj tarifës vjetore për licencë të KPM-së, të bëhet në pajtueshmëri me procedurat e parapara me legjislacionin në fuqi.

6. Këtë vendim e lëshon Komisioni, dhe i njëjti hyn në fuqi që nga data e nënshkrimit.


Muja FERATI
Kryetar
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE



31.01.2019
datë